

KURSI I APOLOGJETIKËS

Një zhytje në thellësitë e apologjetikës dhe ungjillëzimit për t'u pajisur për një shërbesë të frytshme.

Në përfundim të kursit studenti pajiset me
“Certifikatë në Apologjetikën e Krishterë”.

“Nëse një kulturë arrin pikën ku pretendimet e krishtera nuk janë as pjesë e strukturës së saj të besueshmërisë, gjithnjë e më pak njerëz do të jenë në gjendje që t’i pranojnë ato si të vërteta. Kjo është arsyeja pse apologjetika është kaq vendimtare për ungjillëzimin. Apologjetika synon të krijojë një strukturë besueshmërie në mendjen e një personi, ose “kushte të favorshme”... në mënyrë që Ungjilli të mund të pranohet si i vërtetë nga ai person.”

J.P. Moreland, PhD

Në IFCE jemi të bindur se një qasje apologjetike ndaj ungjillëzimit dhe dishepullimit është jashtëzakonisht e nevojshme për të arritur shqiptarët e sotëm me Ungjillin. Të trajnohesh në apologjetikë do të thotë të bëhesh gati për të dhënë “një përgjigje për shpresën” që është në ty, siç na mëson 1 Pjetri 3:15. Për këtë arsye, të ftojmë të marrësh pjesë në Kursin e Apologjetikës për të mësuar nga disa prej ekspertëve më të njohur në fushat e studimeve biblike, teologjisë, apologjetikës, shkencës dhe filozofisë, si: William Lane Craig, J. P. Moreland, John Lennox, Stephen Meyer, Douglas Groothuis, Gary Habermas, Josh McDowell, Craig Blomberg, William Mounce dhe Richard Hess.

Së bashku me forcimin e besimit tuaj, do të mësoni se si:

- Të trajtoni pyetje të vështira që ngrihen ndaj besimit të krishterë.
- Të mendoni me kujdes duke përdorur mjetet e logjikës dhe filozofisë.
- Të jepni një përgjigje biblike dhe të arsyeshme.
- Të përmirësoni aftësitë e komunikimit dhe shumë më tepër.



Përkushtimi që kërkohet:

- 2-3 orë në muaj për të përfunduar mësimin online (studenti duhet të kalojë të gjitha kuizet e mësimit).
- Një përmbledhje e shkurtër për çdo mësim, duke u përgjigjur me nga një paragraf për secilin objektiv të mësimit.
- Pjesëmarrje një pasdite në muaj në takimin trajnues të përmuajshëm të IFCE-së në Tiranë (zakonisht do të jetë të shtunën e fundit të çdo muaji). Janë gjithsej 10 takime trajnuese të shtrira në 10 muaj (Tetor 2024 - Korrik 2025). Nga këto, 8 takime janë trajnuese dhe 2 janë Retreat-e (vendi për Retreat-et është për t'u vendosur). Datat ekzakte të takimeve trajnuese dhe Retreat-ve do të njoftohen përmes e-mailit.
- Prezantim të një teme apologjetike (në PowerPoint) në grup të vogël
- Shkrimi i një eseje rreth një teme apologjetike.
- Pagesa: **1000 L** në muaj.

PËRMBAJTJA

Mësimi	Tema	Objektiva	Përkushtimi
1	Çfarë është Apologjetika?	<ul style="list-style-type: none"> Të mësojmë se çfarë është apologjetika e krishterë dhe cila është rëndësia e saj. Të njohim marrëdhënien midis apologjetikës dhe teologjisë dhe cilët ishin disa nga apologjetët e kishës së hershme. Të kuptojmë bazën biblike për të bërë apologjetikë. Të dallojmë ndryshimin midis apologjetikës dhe ungjillëzimit. Të njihemi me disa nga metodat apologjetike. 	2.5-3 orë
2	Apologjetika dhe Filozofia	<ul style="list-style-type: none"> Të kuptojmë lidhjen e Apologjetikës me Filozofinë . Të njohim shkurtimisht se si kanë ndërvepruar gjatë historisë mendimet filozofëve kryesorë me mendimin e Krishterë. 	2.5-3 orë
3	A ekziston Zoti? Argumenti Kozmologjik	<ul style="list-style-type: none"> Të familiarizohemi me disa terma teologjikë. Të adresojmë disa kundërshtime që ngrihen ndaj Teologjisë Natyrore dhe të japim shpjegimet përkatëse. Të kuptojmë se pse besimi është i arsyeshëm. Të njihemi me argumentin kozmologjik për ekzistencën e Zotit. 	2.5-3 orë
4	A ekziston Zoti? Argumenti i Projektimit Inteligjent	<ul style="list-style-type: none"> Të njihemi me argumentin e Projektimit Inteligjent për ekzistencën e Zotit. Të diskutojmë disa nga kushtet antropike që kanë zbuluar shkencëtarët, të cilat janë tregues të qartë të mirësinkronizimit të universit. Të dallojmë dy kundërshtime të zakonshme ndaj Argumentit të Projektimit Inteligjent, siç janë, universi i shumëfishtë dhe teoria e evolucionit. 	2.5-3 orë
5	A ekziston Zoti? Argumenti Moral	<ul style="list-style-type: none"> A janë faktet morale të vërteta objektive apo subjektive (relative)? Kundërshtime ndaj moralit objektiv. A e hedh poshtë moralin objektiv të krishterimit dilema e Euthifroit? 	2.5-3 orë
6	Kundërshtime ndaj ekzistencës së Zotit	<ul style="list-style-type: none"> Të shqyrtojmë disa nga kundërshtimet më të shpeshta kundër ekzistencës së Zotit. Të zotërojmë një përgjigje të arsyeshme për këto kundërshtime. 	2.5-3 orë

7	Besueshmëria e Biblës	<ul style="list-style-type: none"> • Të dallojmë se çfarë e bën unike Biblën. • Të artikulojmë se pse Dhiata e Re dhe Dhiata e Vjeter janë të besueshme. • Të rritemi në sigurinë që dorëshkrimet biblike janë trasmetuar me saktësi përgjatë shekujve. • Të mësojmë të adresojmë kritikën e skeptikëve ndaj Jezusit historik. 	2.5-3 orë
8	A u ringjall me të vërtetë Jezu Krishti?	<ul style="list-style-type: none"> • Të dallojmë rëndësinë që ka ringjallja e Krishtit në Krishtërim • Të njihemi me faktet që konsiderohen të gjithëpranuara nga studuesit e fushës dhe pse ringjallja është shpjegimi më i mirë i atyre fakteve • Të pajisemi për të adresuar disa nga kundërshtimet më të zakonshme ndaj ringjalljes së Krishtit. 	2.5-3 orë
9	Kundërshtime ndaj Teizmit të Krishterë	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojmë dhe të pranojmë përgjegjësinë që kemi ne si besimtarë për t'iu përgjigjur atyre që pyesin për shpresën që kemi në Krishtin. • Të aftësohemi për të adresuar disa nga kundërshtimet më të zakonshme që ngrihen kundër krishterimit. 	2.5-3 orë
10	Doktrina e Trinitetit	<ul style="list-style-type: none"> • Të njohim mbështetjen biblike të kësaj doktrine • Të shqyrtojmë disa përkufizime teologjike • Të dallojmë disa pikëpamje heretike rreth Trinitetit • Të analizojmë disa ilustrime për të shpjeguar këtë doktrinë • Të konsiderojmë disa nga implikimet praktike të Trinitetit • Të përgatitemi për t'iu përgjigjur kundërshtimit të Islamit 	2.5-3 orë
11	Traditat e tjera fetare në Shqipëri	<ul style="list-style-type: none"> • Të njihemi me mësimet e feve kryesore në vendin tonë. (Katolicizmi, Ortodoksia, Myslimanizmi, Bektashizmi) • Të dallojmë doktrinën themelore të disa prej sekteve që operojnë në Shqipëri: (Mormonët, Dëshmitarët e Jehovait, Kisha e Unifikimit ose Federata e Familjes) 	2.5-3 orë
12	Çfarë është Ungjilli?	<ul style="list-style-type: none"> • Të jemi në gjendje të bëjmë një prezantim konciz të ungjillit duke ndjekur planin shpengues të Biblës 	2.5-3 orë